



Titulli: **Shtatë përqindëshi i sigurimeve shëndetësore**  
Autore: **Bardha Çollaku**

Kosova, si shtet në ndërtim, ka kaluar nëpër shumë sfida të cilat janë vështirë të transmetohen. Ndër kryesoret theksohet të jetë cilësia në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Pakënaqësitë e qytetarëve me shërbimet shëndetësore gjithnjë e më shumë po shtohen. Ne jetojmë në një shtet ku më pak se 3% e prodhimit të brendshëm bruto përdoret për shëndetësi. Kjo shifër është relativisht e vogël krahasuar me shtetet në rajon dhe në botë. Kjo shifër pamundëson zhvillimin e duhur të shërbimeve shëndetësore dhe krijon panikë tek qytetarët, e cila është shtysë për marrjen e shërbimeve në vendet rajonale.

Kuptohet që Kosova është në zhvillim e sipër dhe kushtet mund të jenë të limituara, megjithatë shëndetësia duhet të jetë primare pasi që e gjithë mirëqenia e njeriut varet nga shëndeti. Kosova, momentalisht nuk ofron shërbime shëndetësore gratis për qytetarët, ajo se çfarë ka ofruar deri tani është lehtësim përmes fondit të të ardhurave nga qytetarët. Sidoqoftë, përpjekjet janë të shumta dhe nuk po ndalen për përmirësimin e gjendjes së tanishme. Ministria e Shëndetësisë është në fazë të reformave dhe ndërtimit të infrastrukturës ligjore për të ngritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Çka ofrojnë ligjet e reja?

Reformat ligjore dhe zbatimi i tyre do të ofrojë shërbime shëndetësore më efektive dhe efikase. Më saktësisht, Ligji mbi Sigurimet Shëndetësore, i cili është në përgatitjen e bazës administrative ka arritur fazat e fundit, do të sigurojë përkujdesje shëndetësore më cilësore publike/private. Ndërkaq, Ligji për Partneritet Publiko-Privat do të sigurojë përdorimin e të gjitha resurseve duke përfshirë pajisjet dhe stafin adekuatë mjekësorë në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve mjekësore. Partneriteti publiko-privat mund të sigurojë shfrytëzimin e sallave të ndryshme operative, diagnostika dhe hemodializa të bëhet në institucionet të cilat kanë aparatura më moderne dhe bëhet çasja e tyre më e shpejtë.

Një ndër hapat kryesor që po ndërmerret për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve janë reformat për ofrimin e sigurimit shëndetësor për çdo qytetar. Ndërkaq, dilema më e madhe lidhur me këtë ligj është përqindja

Sallonet e së martës janë një nismë javore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Salloni ka format gjysmë-formal sipas rregullës Chatham House. dhe pa prani të mediave. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus mbi temat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në

[www.youtube.com/user/TuesdaySalon](https://www.youtube.com/user/TuesdaySalon). Secili Sallon përcjellet me një editorial që publikohet në gazetën Zëri të martën e ardhshme. Podcastet bazuar në editorialet mund të gjenden në [d4d-ks.org/sallonet/podcast-per-sallone](https://d4d-ks.org/sallonet/podcast-per-sallone). **Sot, më 24 maj në Mitrovicë, nga ora 16:45, Salloni i radhës me temën: “A janë të rinjtë më shumë apo më pak fetarë se prindërit e tyre?”**

(7%) e cila duhet të paguhet nga të ardhurat e qytetarëve. Duke marrë parasysh që 3.5% do të paguhet nga punëdhënësi dhe 3.5% tjera nga punëmarrësi, kjo përqindje dukshëm i redukton pagesat nga xhepi vetanak. Andaj, dilema sillet rreth asaj se sa jemi të gatshëm të paguajmë 7% të të ardhurave tona për përkujdesje shëndetësore më cilësore publike/private, gjë që u diskutua edhe në sallonin e së martës nga Instituti D4D.

Shifra prej 7% garanton një sistem të qëndrueshëm e afatgjatë. Nga të dhënat e marra në Ministrinë e Shëndetësisë, në vitet e para të zbatimit të sigurimeve shëndetësore, fondi do të sigurojë 60 deri në 80 milion buxhet i cili do t'i shtohet buxhetit të tanishëm, gjë që krijon hapësirë për investime të nevojshme dhe shërbime cilësore. Ndërkaq, pasi të stabilizohet dhe të funksionojë në vazhdimësi sigurimet shëndetësore do të sigurojnë rreth 100 milion, shifër e cila garanton qytetarët dhe punëtorët se përqindja e paguar nga ta do të jetë në qarkullim të vazhdueshëm për përmirësimin e kushteve të tanishme shëndetësore dhe gjithashtu ofrimin e shërbimeve më cilësore. Megjithatë, duhet të merret parasysh fakti se fondet janë kriza e borxheve publike dhe se mundësia që shteti të hyjë në borxh publik është shumë e lartë. Duhet të shtohet kujdes i veçantë se ku do investohen mjetet dhe se sa nga shpenzimet do të mbulojnë. Menaxhimi i mirëfilltë dhe kapaciteti i nevojshëm administrativ do të mundësojë funksionimin e rregullt të fondit. Më pas mirren me çmimet që do të na ofrohen, të cilat do jenë të njëjta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, barnat e pranueshme për përdorim me emër gjenerik dhe më tutje për përmirësimin e kushteve.

Bazuar në statistika të kompanive të sigurimeve shëndetësore, në Kosovë çmimi mesatar për një sigurim të thjeshtë shëndetësorë kushton rreth 17-21 euro. Në rast se aplikohet 7%-shi i obliguar për sigurime shëndetësore, atëherë kjo përqindje është e arsyeshme meqë 7% i një rroge mesatare në Kosovë (që është rreth 360 euro) është rreth 25 euro, shumë që e mbulon sigurimin bazik. Më tutje, punëtorët do të mund të marrin një sigurim vullnetarë plotësues që mbulon shpenzime tjera mjekësore sipas zgjedhjes së tyre. Pra bazuar në ligjin e ri për sigurime shëndetësore, fondi për sigurime shëndetësore do të kapitalizohet nga taksapaguesit e rregullt që sigurojnë të ardhura vjetore të cilët janë të punësuar në institucione publike, private, apo publiko-private, me qarkullim të institucioneve së paku 50 mijë euro, institucione qe tani janë të obliguar të paguajnë për sigurime shëndetësore. Duhet cekur se në këtë pagesë hyjnë anëtarët e ngushtë të familjes duke përfshi prindërit, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare. Ndërkaq, familjet me ndihmë sociale dhe shumë të tjerë janë të përjashtuar nga kjo pagesë.

Shtatë përqindëshi i sigurimeve shëndetësore ka ndikim të dyfishtë tek qytetarët, duke rritur cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ajo redukton pagesat nga xhepi vetanak të qytetarëve. Siguria që ofron ky ligj tek qytetarët dhe punëtorët është shumë e lartë, prandaj menaxhimi i rregullt do të mundësojë kapacitet më të madh të shërbimeve, shërbime kualitative, dhe infrastrukturë me aparatura të nevojshme.